

DOKUMENT AVOKIMI

Nga Qëllimi te Ndikimi

Zbatimi i Ligjit të Ri për Rininë



Organization for Security and
Co-operation in Europe
Mission in Kosovo

Misioni i OSBE-së në Kosovë (Misioni) ka kohë që shtynë përpara pjesëmarrjen publike e të rinjve si pjesë e mandatit të tij për të promovuar të drejtat e njeriut, demokratizimin dhe përfshirjen. OSBE-ja nuk ka kursyer asnjë përpjekje në mbështetje të zhvillimit të kuadrit të ri ligjor dhe rregullator për të rinjtë, veçanërisht Ligjit për Rininë të vitit 2024 dhe Rregullores për Këshillat Rinorë, të cilat shënojnë hap të madh drejt formalizimit të përfshirjes publike të të rinjve.¹² Kjo përmbledhje – e adresuar tek të gjitha palët e interesit të nivelit qendrorë dhe lokalë të përfshirë në krijimin e këshillave rinorë – synon të shfrytëzojë plotësisht potencialin e reformës ligjore dhe të politikave për të gjeneruar ndryshim pozitiv, duke marrë parasysh rrethanat specifike në nivel lokal për të zmadhuar më tutje rëndësinë e kësaj reforme.

SFIDAT KRYESORE

Falë hulumtimeve nga zyra, anketave dhe takimeve informuese të të rinjve me komunat dhe akterët rinorë në nivel lokal³, Misioni identifikoi shqetësimet në lidhje me zbatimin e kuadrit të ri ligjor dhe nënligjor për të rinjtë.

Koordinimi dhe tranzicioni

Kalimi nga këshillat e veprimt rinor lokal (KVRL) në këshillat rinore lokale (KRL) ka krijuar pasiguri rreth roleve dhe përgjegjësisë, tek të rinjtë që kanë frikë nga dyfishimi dhe komunat që nuk janë të sigurta për rolin e tyre të ri lehtësues. Ruajtja e praktikave pozitive ekzistuese është sfida e rëndësishme, ndërsa opsionet për koordinim, komunikim, mbështetje institucionale dhe harmonizim të prioritetëve lokale mbeten të përcaktuara në mënyrë të paqartë.

Mbështetja institucionale dhe financiare

Përkundër kërkesës urgjente për ndërtim të kapaciteteve, është e paqartë nëse Agjencia për Zhvillimin e të Rinjve (AZHR) mund t'i përbushë në mënyrë efektive kompetencat e saj. Komunat kanë theksuar gjithashtu nevojzën për bazë të qartë ligjore që lejon financimin publik të KRL-ve në përputhje me ciklet buxhetore, si dhe për udhëzime dhe standardizim të procedurave për themelimin dhe mbështetjen e këshillave rinorë.

Qëndrueshmëria dhe motivimi

Natyra joformale dhe vullnetare e pjesëmarrjes në Këshillat Qendror Rinor (KQR) dhe KRL ngritë shqetësimet në lidhje me qëndrueshmërinë afatgjatë, pasi mungesa e nxitjes mund të minojë angazhimin e vazhdueshëm të të rinjve. Ende mungon një kuadër i ri legjislativ i përgjithshëm mbi vullnetarizmin, që nuk kufizohet vetëm në vullnetarizmin e të rinjve, për të krijuar nxitje të vërtetë për pjesëmarrjen e të rinjve në jetën publike.

Ndërgjegjësimi dhe ndërtimi i kapaciteteve

Më pak se gjysma e të rinjve të intervistuar janë të njohur me kuadrin e ri ligjor, gjë që krijon boshllëk ndërgjegjësimi dhe rrezikon të kufizojë zbatimin efektiv. Si të rinjtë ashtu edhe akterët komunalë kërkuar trajnim praktik mbi metodat e pjesëmarrjes, mbledhjen e fondeve dhe avokimin, punën me komunitetin, monitorimin e politikave dhe koordinimin institucional.

Përfshirja dhe përfaqësimi

Forcimi i kontaktit me grupet e marginalizuara, duke përfshirë të rinjtë me aftësi të kufizuara dhe ata nga komunitetet jo-shumicë, mbetet sfida kritike për të ruajtur funksionin përfaqësues të këshillave. Duhet të merret në konsideratë edhe ndikimi politik dhe, sa herë që është e nevojshme, të zbutet, pasi që rrezikon përfaqësimin e këshillave.

¹ Ligji Nr. 08/L-264 për Rininë, i disponueshëm në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=95847>

² Rregullorja (MSR) Nr. 09/2024 për Këshillat Rinor, e miratuar nga Ministri me Vendimin Nr. 140/2024, datë 31.12.2024, i disponueshëm në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=10011>

³ Misioni e kreu këtë hulumtim midis marsit dhe majit 2025, duke përfshirë 40 të anketuar në anketë dhe gjashtë takime informuese në 26 komuna duke angazhuar mbi 100 palë të interesuara rinore.

THIRRJA PËR VEPRIM

Për të realizuar plotësisht potencialin e kornizës së re rinore, Misioni rekomandon që miratimi i masave legjislative dhe rregullative të plotësohet me masa konkrete, duke siguruar kështu që këshillat rinorë të bëhen platforma efektive, gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme për pjesëmarrjen e të rinjve.

Koordinimi për angazhim kolektiv

Komunikimi i fortë midis Ministrinë e Sportit dhe Rinisë (MSR-së), komunave, këshillave rinorë dhe shoqërisë civile duhet të bëhet rregull, jo përjashtim. Bashkërendimi i strategjive komunale me planet e KRL do të krijojë qëndrueshmëri dhe do ta rrisë ndikimin. Ish-anëtarët e KVRL-së mund të shërbejnë si mentorë, duke siguruar që përvoja e vlefshme të çohet përpara dhe të përdoret për të forcur strukturat e reja rinore.

Institucione të forta për një sektor rinor të fortë dhe të qëndrueshëm

Asnjë strukturë rinore nuk mund të lulëzojë pa mbështetje institucionale dhe financiare. Komunat duhet të integrojnë financimin e KRL-së në buxhetet e tyre vjetore, të ofrojnë hapësira pune dhe burime logjistike, si dhe të caktojnë zyrtarë rinorë për të udhëzuar këshillat, duke ruajtur njëkohësisht pavarësinë e tyre. Progresi i komunave në krijimin e KRL-ve duhet të monitorohet për llogaridhënie. AZHR duhet të jetë plotësisht funksionale dhe e aftë për të ofruar asistencë teknike dhe për të përfurcuar bashkëpunimin në të gjitha nivelet.

Kultivimi i motivimit për angazhim të qëndrueshëm

Motivimi nxit vazhdimësinë. Njohja e angazhimit të të rinjve përmes certifikatave, krediteve akademike ose përfitimeve të lidhura me karrierën do ta bëjë pjesëmarrjen e tyre të qëndrueshme dhe do të nënvizojë vlerën e saj. Njohja e dukshme e kontributeve të të rinjve në proceset e politikave dhe vendimmarrjes do të ndihmojë në institucionalizimin e këshillave rinorë si platforma të besueshme dhe të qëndrueshme për dialog demokratik dhe udhëheqje në komunitet.

ROLI I MISIONIT TË OSBE-SË NË KOSOVË

Misioni i OSBE-së në Kosovë mbetet partner i besueshëm dhe strategjik për institucionet, organet rinore dhe shoqërinë civile për përkthimin e kornizës së re rinore në praktikë dhe për rezultate të prekshme. Duke shfrytëzuar mandatin e tij unik dhe praninë në terren, Misioni lidh politikatat dhe pjesëmarrjen—duke forcur kapacitetet institucionale për të hartuar dhe zbatuar politika me rininë në qendër, duke i fuqizuar të rinjtë për t'u angazhuar me vetëbesim me vendimmarrësit dhe duke nxitur dialogun dhe mirëbesimin si elementë thelbësorë për qeverisjen dhe qëndrueshmërinë demokratike.

Ndërtimi i njohurive dhe aftësive

Ndërgjegjësimi duhet të çojë në fuqizim. AZHR, e mbështetur nga partnerë - si Misioni - duhet të udhëheqë programe trajnimi gjithëpërfshirëse dhe praktike mbi planifikimin pjesëmarrës, avokimin dhe zbatimin e projekteve. Një fushatë ndërgjegjësimi shumëgjuhëshe dhe miqësore për të rinjtë duhet t'i bëjë të drejtat, rolet dhe mundësitë sipas sistemit të ri të qarta dhe të arritshme për të gjithë.

Përfshirja në thelb

Diversiteti është forca e çdo procesi demokratik. Komunat dhe shoqëria civile duhet të sigurojnë përzgjedhje të hapur dhe transparente të anëtarëve të këshillit duke zbatuar komunikim efektiv me publikun. Masat e synuara të kontaktimit dhe mbështetjes duhet të nxisin pjesëmarrjen e të rinjve nga komunitetet jo-shumicë, zonat rurale dhe personat me aftësi të kufizuara, duke siguruar që çdo zë i të rinjve të ketë rëndësi në formësimin e vendimeve lokale.



UDHËRRËFYES PËR ZHBLOKIM TË POTENCIALIT TË PLOTË TË REFORMËS RINORE

Koordinimi dhe Tranzicioni

- Forconi komunikimin
- Përshtatni strategjitë
- Përdorni kujtesën institucionale

Ndërgjegjësimi dhe Ndërtimi i Kapaciteteve

- Zhvilloni dhe zbatoni trajnime dhe mentorim
- Nisni fushatë ndërgjegjësimi shumëgjuhëshe, miqësore për të rinjtë
- Përdorni doracakun e OSBE-së

Mbështetja Institucionale dhe Financiare

- Funkcionalizimi i plotë i AZHR-së
- Sqaroni rrugët ligjore të financimit për KRL-të si grupe joformale
- Siguroni mbështetje komunale për KVL-të

Përfshirja dhe Përfaqësimi

- Garantoni përzgjedhje transparente dhe gjithëpërfshirëse
- Promovoni pjesëmarrjen e të rinjve të marginalizuar

Qëndrueshmëria dhe Motivimi

- Vendosni sisteme digjitale dhe fizike të mbajtjes së procesverbaleve
- Avokoni për ndryshime në politika ose ligje
- Mbështetni dhe monitoroni progresin e komunës